

STATUTI I

TATE IT SHPK

Në përputhje me ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar, si dhe legjislacionin në fuqi në Republikën e Shqipërisë: Dr. Elis Tarelli, shtetas gjerman, lindur më 08.09.1978, mbajtës i pasaportës me numër CG6P4PFR8, në cilësinë e tij si Ortak i Vetëm, vendos të miratojë në datë 07.08.2023, Statutin aktual të TATE IT sh.p.k., (më poshtë referuar si “Statuti”).

KAPITULLI 1

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1 Emri

Emri i shoqërisë është TATE IT (më poshtë referuar si “Shoqëria”).

Neni 2 Forma Ligjore

TATE IT është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (Shpk), e themeluar, organizuar dhe që ushtron veprimtarinë e saj në përputhje me legjislacionin e Republikës së Shqipërisë.

Neni 3 Selia

- 3.1. Selia e Shoqërisë është në adresën: Rruga „Lulzim Sulollari“, PLL. Nr. 1, H.1, 7301 Pogradec, Shqipëri” (banesë në pronësi të Administratorit).
- 3.2. Shoqëria, me vendim të administratorit, mund të hapë dhe / ose mbyllë degë, filiale, agjenci dhe/ose zyra përfaqësimi, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.

Neni 4 Objekti i veprimtarisë

- 4.1. Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë përfshin midis të tjerash, por nuk kufizohet vetëm në:
 - i) Shërbime konsulence të teknologjisë së informacionit (IT);
 - ii) Ndërmjetësim për shërbime të teknologjisë së informacionit, përfshirë edhe shërbime programimi apo kodimi në fushën e IT;
 - iii) Veprimtari në fushën shitblerjes së pasurive të paluajtshme për qëllime biznesi
 - iv) Veprimtari të tjera të lejuara nga legjislacioni i zbatueshëm në fuqi.
- 4.2. Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë mund të ndryshohet / shtohet me vendim të Ortakut të Vetëm, në përputhje me legjislacionin në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

Neni 5 Kohëzgjatja

- 5.1. Shoqëria është themeluar dhe do të ushtrojë veprimtarinë e saj për një kohëzgjatje të pacaktuar, duke filluar nga data e regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar.

- 5.2. Prishja dhe likuidimi i Shoqërisë do të kryhet me vendim të Ortakut të Vetëm, në përputhje me dispozitat e këtij Statuti dhe legjislacionit në fuqi.

KAPITULLI 2

KAPITALI THEMELTAR DHE PRONËSIA

Neni 6 Kapitali Themeltar

- 6.1. Kapitali themeltar i Shoqërisë është 5.000 (pesëmijë) Lekë.
- 6.2. Kapitali përbëhet nga 1 (një) kuotë me vlerë nominale të barabartë me 5.000 (pesëmijë) Lekë.
- 6.3. Kuota është e transferueshme në çdo kohë, në përputhje me kushtet e legjislacionit në fuqi.
- 6.4. Kontributi i Ortakut të vetëm është në para dhe shlyhet menjëherë pas regjistrimit të Shoqërisë nëpërmjet pagimit në llogarinë bankare të Shoqërisë.
- 6.5. Përgjegjësia e Ortakut të Vetëm është e kufizuar deri në vlerën e pashlyer të kontributit të tij në kapitalin themeltar.

Neni 7 Pronësia mbi Kuotën

Pronar dhe Ortak i Vetëm i Shoqërisë është zoti Elis Tarelli, shtetas gjerman, lindur më 08.09.1978, mbajtës i pasaportës me numër CG6P4PFR8, zotërues i 1 (një) kuote, e cila përbën 100% (njëqind përqind) të kapitalit themeltar, me vlerë 5.000 (pesëmijë) Lekë”.

Neni 8 Transferimi i Kuotës

Ortaku i Vetëm mund të vendosë transferimin e të gjithë kuotës, ose një pjese të saj, nëpërmjet shitjes, dhurimit ose nëpërmjet çdo mënyre tjetër të lejuar nga legjislacioni në fuqi.

Neni 9 Rritja dhe zvogëlimi i kapitalit

- 9.1. Kapitali themeltar mund të rritet duke rritur vlerën e Kuotës ekzistuese si rrjedhojë e kontributeve në para dhefose natyrë, ose nëpërmjet çdo formë tjetër të lejuar nga ligji.
- 9.2. Kapitali themeltar mund të rritet ose zvogëlohet me vendim të Ortakut të Vetëm. Në çdo rast, kapitali themeltar nuk mund të zvogëlohet nën vlerën minimale të përcaktuar nga ligji.

KREU 3

ORGANIZIMI I SHOQËRISË

Neni 10 Ortaku i Vetëm

- 10.1. Ortaku i Vetëm është organi më i lartë vendimmarrës i Shoqërisë.

10.2. Shoqëria është përgjegjëse dhe do të përgjigjet për detyrimet me të gjitha pasuritë e saj. Ortaku i Vetëm mund të marrë vendime mbi çështjet e mëposhtme:

- i) përcaktimin e politikave të tregtare të Shoqërisë;
- ii) ndryshimin e Statutit të Shoqërisë;
- iii) emërimin dhe shkarkimin e administratorit/ëve;
- iv) emërimin dhe shkarkimin e likuiduesit/ve dhe audituesit/ve ligjorë;
- v) rritjen ose zvogëlimin e kapitalit themeltar;
- vi) miratimin e pasqyrave financiare, raporteve mbi ecurinë e veprimtarisë dhe shpërndarjen e fitimeve vjetore,
- vii) miratimin e shpërblimeve për administratorin/rët, likuiduesin/it dhe audituesin/it ligjorë,
- viii) riorganizimin, prishjen, transformimin, bashkimin me përthithje, ndarjen, ose likuidimin e shoqërisë ose shndërrimin e formës ligjore të saj;
- ix) pjesëmarrjen në kapitalin themeltar të çdo shoqërie tjetër,
- x) Çështje të tjera, siç parashikohet nga legjislacioni i zbatueshëm dhe/ose ky Statut.

Neni 11 Regjistri i Vendimeve

11.1. Të gjitha vendimet e marra nga Ortaku i Vetëm do të regjistrohen në Regjistrin e Vendimeve, përmbajtja e të cilit nuk mund të fshihet ose ndryshohet. Në veçanti, duhet të regjistrohen vendimet e mëposhtme:


- i) miratimet e pasqyrave financiare dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ii) shpërndarja e fitimeve vjetore dhe mbulimi i humbjeve;
- iii) rritja ose zvogëlimi i kapitalit themeltar;
- iv) vendimet në lidhje me investimet;
- v) riorganizimi dhe prishja e Shoqërisë.

11.2. Lista e mësipërme nuk është shteruese dhe vendimet të cilat nuk janë të regjistruara në Regjistrin e Vendimeve do të konsiderohen të pavlefshme.

Neni 12 Administratorilët

12.1. Ortaku i Vetëm cakton një ose më shumë individë si administratorë të Shoqërisë. Administratorët emërohen nga Ortaku i Vetëm për një periudhë 5 (pesë) vjeçare, në fund të së cilës mandati mund të ripërtërihet me vendim të Ortakut të Vetëm. Gjatë mandatit, Ortaku i Vetëm mund të vendosë të shkarkojë ndonjë prej Administratorëve, në çdo moment.

12.2. Administratori i Shoqërisë do të jetë si vijon:

Zoti Elis Tarelli, shtetas gjerman, lindur më 08.09.1978, banues në Nyremberg (Gjermani) mbajtës i pasaportës me numër CG6P4PFR8.	Specimeni i nënshkrimit 
Zoti Qirjako Tarelli, shtetas shqiptar, lindur më 06.08.1947, banues në	



Pogradec, mbajtes i pasaportës me numër BA9228677.	
--	--

- 12.3. Secili prej administratorëve ka të drejtë të përfaqësojë dhe administrojë Shoqërinë me të drejta dhe kompetenca të plota, në përputhje me dispozitat e këtij neni 12. Administratorët do të përfaqësojnë Shoqërinë në mënyrë të pavarur nga njëri tjetri.
- 12.4. Pa u kushtëzuar nga Neni 12.3 më lart, Administratorët do të kenë përgjegjësitë e mëposhtme:
- i) menaxhimi i veprimtarisë tregtare të Shoqërisë, në përputhje me politikën tregtare të vendosura nga Ortaku i Vetëm,
 - ii) përgatitja e rregulloreve të brendshme të Shoqërisë:
 - iii) analiza, ndryshimi dhe përmirësimi, përpara datës 1 dhjetor të çdo viti, planin e biznesit dhe buxhetin për vitin pasardhës:
 - iv) përgatitja, nënshkrimi dhe paraqitja për miratim përfundimtar tek Ortaku i Vetëm, deri më 31 Mars të çdo viti pasardhës, e raportit të veprimtarisë së Shoqërisë, pasqyrat financiare, raportin e auditimit (nëse ka) për vitin paraardhës dhe, gjithashtu, inventarizimin e aseteve dhe detyrimeve të Shoqërisë deri në këtë datë:
 - v) hartimi i raportit të menaxhimit dhe paraqitja e tij tek Ortaku i Vetëm për miratim,
 - vi) përfaqësimi i Shoqërinë përpara çdo pale të tretë publike dhe/ose private, qofshin këto vendase dhe ose të huaja, përfshirë të gjithë autoritetet në Republikën e Shqipërisë, të tilla si, por pa kufizuar vetëm në to, autoritetet tatimore dhe/ose administrative, si dhe nënshkrimi, paraqitja dhe ose tërheqja e çdo dokumentacion të nevojshëm dhe/ose përshtatshëm për veprimtarinë e Shoqërisë dhe, në përgjithësi, veprimi në emër dhe për llogari të saj në lidhje me çdo çështje siç parashikohet nga legjislacioni i zbatueshëm:
 - vii) miratimi i skemës organizative të Shoqërisë, si dhe punësimi dhe shkarkimi i personelit të saj, në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm:
 - viii) mbajtja dhe përditësimi i regjistrit që përmban të gjitha të dhënat e Shoqërisë, përfshirë Regjistrin e Vendimeve siç tregohet në nenin 11 të këtij Statuti:
 - ix) nënshkrimi i urdhërpagesave dhe/ose çeqeve, si dhe/ose autorizimi i ngarkimit të shpenzimeve dhe/ose pagesave në llogarinë bankare të Shoqërisë dhe/ose të vendosja e garancive:
 - x) të kërkojnë dhe të arkëtojnë të ardhurat e Shoqërisë dhe të kryejnë depozitime në llogaritë bankare të Shoqërisë:

- xi) Hapja e llogarive bankare dhe/ose transferimi i fondeve përkatëse ndërmjet llogarive bankare të Shoqërisë dhe/ose ndërmjet llogarive bankare të Shoqërisë dhe llogarive bankare të çdo pale të tretë, në përputhje me këtë Statut dhe legjislacionin e zbatueshëm;
 - xii) nënshkrimi i marrëveshjeve të shërbimeve në lidhje me ofrimin e shërbimeve profesionale nga e Shoqërisë, pa asnjë kufizim në shumat përkatëse.
- 12.5. Kompetenca dhe detyrat e mëposhtme do të ushtrohen nga administratorët me kundërnënshkrimin e një përfaqësuesi të autorizuar, i cili do të caktohet, rast pas rasti, nga Ortaku i Vetëm:
- i) transferimi i fondeve që tejkalojnë vlerën 50.000 (pesëdhjetëmijë) Lekë nga llogaritë bankare të Shoqërisë;
 - ii) lidhja e kontratave të kredisë që tejkalojnë vlerën 100 000 (njëqind mijë) Lekë;
 - iii) lidhja e kontratave të dhurimit ku Shoqëria është pala dhuruese, me vlerë mbi 50,000 (pesëdhjetëmijë) Lekë;
 - iv) emërimi dhe zëvendësimi i personave të autorizuar për kryerjen e veprimeve me llogaritë bankare dhe fondet e kredisë së Shoqërisë;
 - v) lidhja e marrëveshjeve që përmbajnë detyrime me vlerë mbi 100.000 (njëqind mijë) Lekë për Shoqërinë, përveç: marrëveshjeve të shërbimit me klientë, marrëveshjeve me nënkontraktorë për marrëveshjet e shërbimit të lidhura me klientë, marrëveshjeve të punësimit;
 - vi) kur shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5% të asetëve të shoqërisë, që rezultojnë nga pasqyrat e fundit financiare të certifikuara,
 - vii) lidhja e marrëveshjeve për garantimin e detyrimeve të palëve të treta;
 - viii) lidhja e marrëveshjeve për blerjen ose shitjen e pasurive të paluajshme;
 - ix) lidhja e marrëveshjeve të qirasë për pronat të paluajshme, psh. për ambiente jo-banimit, apartamente, etj.
- 12.6. Nëse njëri prej Administratorëve nuk respekton ndalesat dhe/ose kufizimet e kompetencave të tij, ai do të jetë përgjegjës për çdo pasojë që do të rezultojë nga këto vendime, duke përfshirë, por pa u kufizuar në, detyrimet për dëme të shkaktuara Shoqërisë, Ortakut të Vetëm dhe/ose palëve të treta.
- 12.7. Administratori do të shkarkohet dhe do të jetë përgjegjës për dëmet nëse vepron në kundërshtim me Statutin ose nëse, pa miratimin paraprak të Ortakut të Vetëm, ka pranuar të jetë Administrator në një shoqëri konkurente ose në një shoqëri me objekt të njëjtë veprimtarie si Shoqëria dhe konkurrenca me të, ose nëse është përfshirë në transaksione të

ngjashme civile ose konkurruese, duke vepruar në emër të tij ose në emër të një individi tjetër dhe/ose personi juridik.

- 12.8. Autorizimi i lëshuar nga administratorët për të përfaqësuar Shoqërinë mund t'i delegohet palëve të treta vetëm për veprime specifike dhe të përcaktuara qartë në një prokurë të posaçme ose rregullore të brendshme, si dhe vetëm brenda kufijve të Statutit dhe me miratim paraprak të Ortakut të Vetëm.

KREU IV DISPOZITA TE TJERA

Neni 13 Viti financiar

Viti financiar i Shoqërisë fillon më 1 janar dhe përfundon më 31 dhjetor. Përfundimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të Shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe mbyllet më 31 dhjetor.

Neni 14 Audituesi/t ligjorë

Nëse kërkohet nga legjislacioni i zbatueshëm, ose nëse miratohet nga Ortaku i Vetëm, kontrolli i pasqyrave financiare dhe librave të Shoqërisë, do t'i besohet një ose më shumë audituesve ligjorë.

Neni 15 Shpërndarja e fitimeve

- 15.1. Vendimet mbi shpërndarjen dhe përdorimin e fitimeve të Shoqërisë duhet të miratohen nga Ortaku i Vetëm.
- 15.2. Ortaku i Vetëm ka të drejtën e përfitimit të 100% (njëqind përqind) të fitimeve të Shoqërisë.

Neni 16 Prishja dhe Likuidimi

- 16.1. Shoqëria mund të priset në bazë të vendimit të Ortakut të Vetëm. Prishja e Shoqërisë do të ndiqet nga procedura e likuidimit.
- 16.2. Ortaku i Vetëm do të caktojë një ose më shumë likuidues, duke përcaktuar kompetencat e tyre në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- 16.3. Prishja dhe likuidimi i Shoqërisë do të kryhet në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar.
- 16.4. Shoqëria do të vazhdojë të ekzistojë si person juridik për qëllim të procedurave të likuidimit deri në përmbylljen e këtyre procedurave, sipas legjislacionit në fuqi. Gjatë procedurës së likuidimit, emri i Shoqërisë do të ndiqet nga shënimi "në likuidim".

KREU V

DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 17

Zgjidhja e mosmarrëveshjes

- 17.1. Ky Statut është i bazuar në legjislacionin shqiptar dhe interpretimi, vlefshmëria dhe zbatimi i tij do të kryhen në përputhje me legjislacionin shqiptar. Dispozitat e ligjit nr. 9901, datë 14.04.2998 “Për tregtarët dhe thoqëritë tregtare” i ndryshuar, do të zbatohen për çështje të paparashikuara nga ky Statut.
- 17.2. Në rast mosmarrëveshesh që lindin nga interpretimi dhe/ose zbatimi i këtij Statuti dhe Jose në lidhje me to, të cilat nuk mund të zgjidhen miqësisht midis palëve, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë do të jetë kompetente për zgjidhjen e tyre. Për një zgjidhje të shpejtë të një mosmarreveshje, palët gjithashtu mund të vendosin për zhvelimin e një arbitrazhi ad hoc ose të organizuar.

Neni 18 Gjuha

Ky Statut u përpilua në 4 (katër) kopje origjinale në gjuhën shqipe.

Ortaku i Vetëm



Dr. Elis Tarelli